



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**OBJEKTIVAT FORMUES DHE KARAKTERISTIKAT E PROGRAMIT
MASTER PROFESIONAL NË INFERMIERI KIRURGJIKALE**

Profili kulturor dhe profesional i studimit në përfundim të programit mësimor

Profesioni i infermierit përbën një kompleks kompetencash (njohurish, shkathtësish, shprehish, qëndrimesh dhe vlerash) të njeriut, që shërben si parakusht për të kryer punë të kualifikuara. Fitohet nëpërmjet të mësuarit sistematik në një institucion arsimit apo formimi ose veprimtarisë në punë dhe përsoset nëpërmjet rritjes së kualifikimit.

Programi i studimit: MP në Infermieri Kirurgjikale synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e infermierisë kirurgjikale. Ai ka për objektive të përgatitjes infermiere kirurgë / anestezistë / reanimatorë me formim të avancuar për të ofruar kujdes shëndetësor të kualifikuar për gjithë njerëzit që vuajnë nga patologji kirurgjikale në moshën e adultit (nga adoleshenca e deri në fund të moshës së tretë).

Ky kualifikim ofron njohuri disiplinare të thelluara në infermieri kirurgjikale të avancuar. Nëpërmjet këtij masteri profesional, studentët aftësohen të demonstrojnë mjeshtëritë në integrimin e koncepteve infermiere në disiplina të ndryshme si dhe aftësinë të zbatojnë njohuritë teknike për të zgjidhur një problem shëndetësor. Gjithashtu i përgatit studentët të realizojnë ndërhyrje bazë të pacientit si dhe ndihmon në përmbushjen e detyrave bazë të kërkuara prej një infermiere profesioniste.

Studentët do të aftësohen gjithashtu për të komunikuar në mënyrë profesionale edhe me publikun për teknikat infermiere kirurgjikale, duke fituar mjeshtëri dhe përvojë në komunikimin formal dhe informal me studentë, infermiere, mjekë dhe specialistë të kujdesit shëndetësor.

Ky master profesional synon të plotësojë kërkesat në rritje të tregut të punës ndërkombëtar për specialistë në fushën e infermierisë kirurgjikale dhe ndihmës reanimator / anestezist.

Në përfundim të programit të studimeve studentët do të marrin diplomën: **Master profesional në Infermieri Kirurgjikale.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor.

Nëpërmjet këtij formimi, studentët ridimensionojnë konceptet për infermierinë kirurgjikale si shkencë e integritit të shkencave teorike bazë në funksion të shfrytëzimit të aparaturave dhe teknikave infermiore jo vetëm për qëllime trajtimi, por edhe për shfrytëzimin e tyre në krijimin e bazave të sigurta shkencore.

Në përfundim të këtij programi të ciklit të dytë të studimeve studentët do të kenë njohuri, vizion, aftësi dhe eksperiencë të mjaftueshme për të ofruar një kujdes infermior me cilësi të lartë, bashkëkohor, të bazuar mbi gjykimin kritik të fakteve tek një spektër i gjerë pacientësh në çdo hallkë të shërbimit kirurgjikal (kirurgji, anestezi, reanimacion).

Duke përdorur një kombinim të mirë-balancuar të instruktiveve didaktike në auditor, seminareve për diskutimin e eksperiencës klinike dhe kompetencës klinike të avancuar në repartet e kirurgjisë, studentët e FSHP në këtë program mësojnë si të masterizojnë dhe integrojnë praktikën e tyre klinike me trajnimin në përmirësimin e cilësisë së shërbimit, lidhshpimin infermior, kërkimin klinik, informatizimin infermioristik dhe politikat shëndetësore e sociale.

Mundësitë për punësim

Në përfundim të këtij programi të ciklit të dytë të studimeve studentët do të kenë njohuri, vizion, aftësi dhe eksperiencë të mjaftueshme për të ofruar një kujdes infermior me cilësi të lartë, bashkëkohor, të bazuar mbi gjykimin kritik të fakteve tek një spektër i gjerë pacientësh në çdo hallkë të shërbimit kirurgjikal:

- Reparti i Kirurgjisë - Terapi Intensive / Spital Rajonal, rrethi apo Spitalet Universitare
- Reparti i mikrokirurgjisë – Spital Rajonal, rrethi apo Spitalet Universitare
- Reparti i Kirurgjisë - Spital Rajonal, rrethi apo Spitalet Universitare
- Urgjenca- Spital Rajonal, rrethi apo Spitalet Universitare, poliklinike
- Kompanitë e kujdesit shëndetësor, spitale, qendra shëndetësore shtetërore dhe private, lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare